

LIGJ
Nr.9738, datë 21.5.2007

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES SË HUASË NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS NDËRKOMBËTARE
PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM (IBRD) PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT TË
ADMINISTRIMIT DHE MENAXHIMIT TË TOKËS”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja e huasë ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD) për financimin e projektit të administrimit dhe menaxhimit të tokës”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5344, datë 7.6.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

MARRËVESHJE HUAJE
(ADMINISTRIMI I TOKËS DHE PROJEKTI I MENAXHIMIT)
NDËRMJET SHQIPËRISË DHE BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM
DHE ZHVILLIM)

Datë_____, 2006

Marrëveshje datës_____ 200 ndërmjet Shqipërisë (Huamarrësi) dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (Banka). Huamarrësi dhe Banka kanë rënë dakord si më poshtë:

Ndërsa Huamarrësi i ka kërkuar Shoqatës të sigurojë ndihmë shtesë në drejtim të financimit të projektit dhe nga një marrëveshje me datë të njëjtë ndërmjet Huamarrësit dhe Shoqatës (Marrëveshje Financiare), Shoqata bie dakord të japë këtë ndihmë në një shumë totale principali të barabartë me dhjetë milionë të drejta speciale tërheqjeje (SDR 10,000,000) (Kredia).

Neni 1

Kushtet e përgjithshme, përkufizimet

1.01 Kushtet e përgjithshme (siç përcaktohet në shtojcën e kësaj Marrëveshjeje) përbëjnë pjesë përbërëse të kësaj Marrëveshjeje.

1.02 Për sa kohë që konteksti nuk e kërkon ndryshe, termat me germa kapitale të përdorura në Marrëveshjen e Huasë kanë kuptimet që u jepen atyre në kushtet e përgjithshme në Marrëveshjen e Financimit ose në shtojcën e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 2

Huaja

2.01 Banka bie dakord t'i japë Huamarrësit, mbi bazë të termave dhe kushteve të parashtruara ose të referuara në këtë Marrëveshje, shumën prej pesëmbëdhjetë milionë e dyqind mijë euro (15,200,000 euro) (Huaja) për të asistuar në projektin e financimit të përshkruar në Planin 1 të Marrëveshjes Financiare (Projekti).

2.02 Huamarrësi mund të tërheqë të ardhurat e Huasë në përputhje me Planin 1 të kësaj Marrëveshjeje.

2.03 Tarifa e angazhimit e pagueshme nga Huamarrësi do të jetë e barabartë me tri të katërtat e një përqind (3/4 e 1%) për vit mbi bilancin e patërhequr të Huasë, duke iu nënshtruar çdo heqjeje dorë nga një pjesë e kësaj tarife, siç mund të përcaktohet nga Banka herë pas here.

2.04 Tarifa fillestare e pagueshme nga Huamarrësi do të jetë e barabartë me një përqind (1.0%) të shumës së Huasë, duke iu nënshtruar çdo heqjeje dorë nga një pjesë e kësaj tarife, siç mund të përcaktohet nga Banka herë pas here.

2.05 Interesi i pagueshëm nga Huamarrësi për çdo periudhë interesi do të jetë me një normë të barabartë me LIBOR për Monedhën e Huasë plus shtrirjen e ndryshueshme që i nënshtrohet heqjes dorë nga një pjesë e këtyre interesave, siç mund të përcaktohet nga Banka herë pas here.

2.06 Datat e pagesës janë 15 maj dhe 15 nëntor të çdo viti.

2.07 Shuma e principalit të Huasë do të shlyhet në përputhje me tabelën e amortizimit të parashtruar në Planin 2 të kësaj Marrëveshjeje.

3.01 Huamarrësi deklaron angazhimin e tij në lidhje me objektivat e projektit. Për këtë qëllim, Huamarrësi nëpërmjet IPRO-s, Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacioneve dhe Ministria e Brendshme do të zbatojnë projektin në përputhje me dispozitat e nenit 5 të Kushteve të Përgjithshme.

3.02 (a) Kushtëzuar nga paragrafi (b) i këtij seksioni, seksionet 3.02 dhe 4.01 të Marrëveshjes Financiare dhe Planit 1 dhe 2 të saj, me përjashtim të seksionit V të Planit 2, përfshihen në Marrëveshjen e Huasë, me modifikimet e mëposhtme në seksionin e mësipërm dhe planet, përsa kohë që konteksti nuk e kërkon ndryshe:

- i) termi "Shoqatë" kuptohet si "Bankë";
- ii) termi "Marrës" kuptohet si "Huamarrësi";
- iii) termi "Kredia" kuptohet si "Huaja" dhe
- iv) termat kjo Marrëveshje" ose "Marrëveshje Financimi" do të lexohen si "Marrëveshje Huaje".

b) Për sa kohë që Huamarrësi njoftohet ndryshe nga Banka:

- i) të gjitha masat e marra, duke përfshirë miratimet e dhëna nga Shoqata sipas çdo seksioni dhe planeve të Marrëveshjes Financiare, të renditura në paragrafin a) të këtij seksioni, si dhe sipas seksionit 2.02 të Marrëveshjes Financiare, do të çmohen të merren në emër si të Shoqatës, dhe të Bankës; dhe

- ii) i gjithë informacioni dhe dokumentacioni i dhënë Shoqatës nga Huamarrësi sipas dispozitave të çdo seksioni të Marrëveshjes Financiare ose planeve të saj, do të konsiderohen që i janë dhënë si Shoqatës, edhe Bankës.

Neni 4

Efektiviteti, përfundimi

4.01 Kushtet shitesë të efektivitetit konsistojnë sa më poshtë, domethënë që Marrëveshja Financiare është ekzekutuar dhe dorëzuar dhe të gjitha kushtet paraprirëse ndaj efektivitetit të saj janë përmbushur, të ndryshme nga ato në lidhje me efektivitetin e kësaj Marrëveshjeje.

4.02 Afati i efektivitetit është data që përkon me nëntëdhjetë (90) ditë pas datës së kësaj Marrëveshjeje.

Neni 5

Përfaqësuesi, adresat

5.01Përfaqësuesi i Huamarrësit është Ministri i Financave.

5.02 Adresa e Huamarrësit është:

Ministria e Financave

Bulevardi: “Dëshmorët e Kombit”

Tirana, Albania

Faks:

+355 42 28494

5.03Adresa e Bankës është:

Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim

1818 H Street, N.W.

Washington, D.C.20433

Shtetet e Bashkuara të Amerikës

Adresa kablllore

INTBAFRAD

Washington,DC

Teleks

248423 (MCI) ose

64145 (MCI)

Faks

1-202-477-6391

Rënë dakord më _____, _____, në ditën dhe vitin e shkruar në sipër.

Shqipëria

Nga

Përfaqësuesi i autorizuar

BANKA NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM

Nga

Përfaqësuesi i autorizuar

PLANI 1

TËRHEQJA E TË ARDHURAVE TË HUASË

A.TË PËRGJITHSHME

1. Huamarrësi mund të tërheqë të ardhurat e Huasë në përputhje me dispozitat e këtij seksioni dhe këtë udhëzim shtesë, siç mund ta specifikojë Banka me njoftim Huamarrësin për të financuar shpenzimet e përshtatshme, të parashtruara në tabelën në paragrafin 2 më poshtë.

2. Tabela e mëposhtme specifikon kategoritë e shpenzimeve të përshtatshme që mund të financohen nga të ardhurat e Huasë (Kategoria), alokimin e shumave të Huasë për çdo kategori dhe përqindjen e shpenzimeve që duhen financuar për shpenzimet e përshtatshme në secilën kategori.

Kategoria	Sasia e Huasë që duhet alokuar (shprehur në euro)	Përqindja e shpenzimeve për t'u financuar
1. Mallrat dhe punimet për pjesën A të projektit	2,770,000	100%

2. Mallrat dhe punimet për pjesën C të Projektit	800,000	100%
3. Shërbimet e konsulencës, trajnimi, shërbimet teknike dhe kostot operacionale të shtuara për pjesën A të projektit	130,000	100%
4. Shërbimet e konsulencës, trajnimi, shërbimet teknike dhe kostot operacionale të shtuara në pjesën C të projektit.	80,000	100%
5. Grante të vogla sipas pjesës C.1 të projektit	11,420,000	50%
6. Tarifa fillestare	0	Sasia e pagueshme sipas seksionit 2.04 të kësaj Marrëveshjeje, në përputhje me seksionin 2.07(b) të kushteve të përgjithshme
Shuma totale	15,200,000	

PLANI 2
PLANI I AMORTIZIMIT

Data e pagesës së principalit	Shuma e principalit të Huasë së pagueshme (shprehur në euro)
15 nëntor 2011	455,000
15 maj 2012	465,000
15 nëntor 2012	475,000
15 maj 2013	485,000
15 nëntor 2013	495,000
15 maj 2014	500,000
15 nëntor 2014	510,000
15 maj 2015	520,000
15 nëntor 2015	530,000
15 maj 2016	540,000
15 nëntor 2016	550,000
15 maj 2017	565,000
15 nëntor 2017	575,000
15 maj 2018	585,000
15 nëntor 2018	595,000
15 maj 2019	605,000
15 nëntor 2019	620,000
15 maj 2020	630,000
15 nëntor 2020	640,000
15 maj 2021	655,000
15 nëntor 2021	665,000
15 maj 2022	680,000
15 nëntor 2022	695,000
15 maj 2023	705,000
15 nëntor 2023	720,000
15 maj 2024	740,000

B. Kushtet e tërheqjes. Periudha e tërheqjes

1. Pavarësisht nga dispozitat e pjesës A të këtij seksioni, nuk do të bëhet asnjë tërheqje për pagesat e bëra para datës së kësaj Marrëveshjeje, përveç tërheqjeve në lidhje me kategorinë (4), deri në një shumë totale që nuk i tejkalon 100,000 euro të barasvlefshme, ndoshta të bëra për pagesat e bëra para kësaj date, por në ose pas datës 1 janar 2007.

2. Data e mbylljes është 31 dhjetor 2011.

SHTOJCA PËRKUFIZIME

1. “Kategoria” nënkupton kategorinë e parashtruar në tabelën në Planin 1 të kësaj Marrëveshjeje.

2. “Marrëveshja e Financimit” nënkupton Marrëveshjen ndërmjet Huamarrësit dhe Shoqatës për projektin, të së njëjtës datë me Marrëveshjen e Huasë, sipas rasteve që kjo Marrëveshje mund të amendohet herë pas here. “Marrëveshja e Financimit” përfshin të gjitha shtojcat, planet dhe marrëveshjet plotësuese të Marrëveshjes së Financimit.

3. “Kushte të përgjithshme”, nënkuptojnë “Bankën Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim”, “Kushtet e Përgjithshme për Huatë”, të datës 1 korrik 2005.